



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor
Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion
Mbledhja nr. 28/2009
Më 01. 12. 2009, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare, Sala Berisha-Shala, Kaqusha Jashari, Nerxhivane Dauti, Fatmir Rexhepi dhe Qamile Morina.

Munguan: Slobodan Petroviq, Ethem Çeku dhe Zef Morina.

Pjesëmarrës të tjerë: Shkumbin Bicaaj, Naim Avdiu - AKP, Haxhi Gashi – USAID, Besim Zeqiri – ICO, Ramadan Klisurica – KDI, Lumnije Murati - ZPRK, Ismet Mahmuti - Zyra për Informim dhe Ibrahim Krasniqi - konsulent i Komisionit.

Nga Zyra Mbështetëse: Hasan Tahiri, Advije Morina, Armend Ademaj dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e drejtoi: Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 24. 11. 2009;
3. Shqyrtimi i Raportit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit gusht 2008 - gusht 2009.
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 24. 11. 2009

Procesverbali i mbledhjes së 24. 11. 2009 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit

Myzejene Selmani – E njoftoi Komisionin se dy përfaqësues të AKP-së kanë ardhur për t'i sqaruar pyetjet dhe dilemat lidhur me Raportin e punës për periudhen gusht 2008 – gusht 2009.

Shkumbin Bicaj - zëvendës drejtor i AKP-se - Sqaroi se ky është një raport i punës njevjeçare, prej momentit kur e kemi marrë si AKP nga AKM-ja (prej gushtit 2008). Raporti kryesisht e përmban përshkrimin e gjendjes si e kemi marrë nga AKM-ja dhe si mendojmë të vazhdojmë më tutje me procesin e privatizimit.

E kemi parë të arsyeshme ta dorëzojmë një raport që t'i sqarojmë shumë përfolje për AKP-në përgjithësi. Hollësisht t'i njoftojmë institucionet përgjigjëse për punën e AKP-së. Në raportin e punës të AKP-së, jepet qartë pasqyra e organizimit tonë dhe rrjedha e privatizimit. E kemi sqaruar privatizimin e tokës bujqësore, sepse dokumentacioni është djegur. Për këtë arsye ka shumë paqartësi në media. AKP-ja lidhur me këtë has në kritika të shumta.

Çështjet që kanë të bëjnë me 20% dhe problemet që po i has AKP-ja janë: pagesat që u takojnë punëtorëve rreth 20%, procesi i likuidimit, që po zgjat tepër dhe procesi i privatizimit. Në ligj shprehimisht thuhet se procesi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore duhet të kryhet sa më shpejt. Në esencë roli i kësaj agjencie është t'i transformojë ndërmarrjet shoqërore nëpërmjet një procesi transparent dhe konkurrues. Më ligj kërkohet që prona shoqërore të kalojë në pronë private. Për këtë shkak për Agjencinë vështirësi që në fillim kanë qenë jashtëzakonisht të mëdha. Në Raport e kemi përshkruar si i kemi marrë kompetencat dhe në çfarë gjendje e kemi gjetur ish-AKM-në. Faktikisht e kemi gjetur pa pajisje elementare të punës, vetëm objektin e zbrazët. Një mori dokumentesh janë gjetur të paarkivuara. Pas një pune të madhe kemi arritur t'i kompletojmë shumë vendime të Bordit të drejtorëve. Pas një presioni legjitim dhe shumë të madh, që ia bëjnë UNMIK-ut, janë kthyer shumë dokumentacione në formë të shkruar dhe elektronike.

Një angazhim i madh i AKP-se është shpërndarja e 20%. Këtu po hasim në vështirësi të jashtëzakonshme. E kemi trashëguar dokumentacionin, që kishte të bënte me lista të shqyrtuara nga gjykata, të cilin nuk e kemi gjetur të kompletuar. Kemi arritur që brenda një kohe të shkurtër ta vëmë këtë proces në binarë. Më vonë u ballafaquam me intrepertimin e ligjit se kush duhet ta kryesojë Komisionin për shqyrtimin e ankesave të 20%. Shumë shpejt e zgjidhëm këtë problem. Deri tani 6000 deri 7000 kërkesa janë shqyrtuar, kurse procedura e hartimit të listave po vazhdon. Kemi angazhur një numër të madh të juristëve, të cilët merren vetëm me 20%. Për listat finale aktualisht jemi në pritje të vendimit të Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme. Posa të merret vendim nga OVGJS-

ja, menjehere do t'i kryejmë transaksionet për punëtorët të cilëve u ka takuar 20%. OVGJS-ja arsyetohet se ka shuma ankesa. U kemi sugjeruar si të veprojnë për rastet e kompletura që të mos zvarriten për shkak të një numri të vogël të ankesave. E kemi një listë të një nderrmarrjeje me 500 veta. Për dy tri ankesa nuk bëhet pagesa sipas kësaj liste. U kemi rekomandur t'i shqyrtojnë kërkesat, por të mos e pengojnë pagesën për shumicën. Procedurat e OVGJS-së për marrjen e vendimeve, që po e zvarrisin punën, janë të komplikuar. Një problem tjetër që e kemi me OVGJS-në është se për ta ende ekziston AKM-ja dhe marrja e vendimeve është komplikuar shumë nga zyrtaret e UNMIK-ut, që ende flasin për ish-AKM-n. Në anën tjetër, me një problem që po ballfqohet Agjencia ka të bëjë edhe me nderrmarrjet që janë privatizuar me Spinof special. Kemi pasur raste kur disa prej tyre i plotësonin kushtet e parapara por nuk ishin nën monitorimin e Agjencisë. Disa raste janë në gjendje shumë të rëndë. Ne si agjenci po i shqyrtojmë mundësitë për masë më ekstreme, që parashihet edhe me kontratë - ushtrimi i tërheqjes së aksioneve. Kemi dhënë disa shpjegime për nderrmarrjet e Gjakovës. Së pari kemi duke punuar për definimin e statusit të tyre, që është kërkesë ligjore. Kur e kemi rifilluar privatizimin si AKP, fillimisht kemi pasur ngadalësim, për shkak të mbikëqyrjes së prejardhjes së parave të blerësve. Kemi filluar me nderrmarrje te vogla, kurse kemi vazhduar me nderrmarrje të mëdha, me një dinamikë të shpejtë. Sa i përket Trepçës, e kemi bërë një moratorium, por juridikisht problem me legjislacionet për ta mbrojtur, edhe pse Trepça ka marrë vazhdimisht subvencione dhe po vazhdon të marrë. Nga buxheti i Kosovës - Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale po u jep 4000 punëtorëve pension të parakohshëm. Sa i përket pjesës Veriore të Trepçës, de fakto, pak kemi qasje. Informacionet që i marrim janë të pakta dhe nuk kemi raporte të drejtpërdrejta.

Myzejne Selmani – Ne, si ligjvënës, e kemi për detyrë ta bëjmë ndryshimin e ligjit, sepse siç vlerësohet problem më vete është ligji në fuqi, i cili do të duhej të pësonte ndryshime dhe plotësime. Ajo vlerësoi se njëri nga problemet themelore është mospërbushja e kontratave sipas Spinofit special. Në vazhdim pos tjerash i shtroi edhe disa pyetje si vijon: *1. Cilët janë objektivat e AKP-së për privatizim më të suksesshëm? 2. Çka do të ndodhë me nderrmarrjet e privatizuara me Spinof special të cilat kanë dështuar, siç është rasiti me Llamkosin dhe 3. Çka po ndodh me kompleksin turistik Brezovica?*

Nerxhivane Dauti - 1. Raporti i paraqitur për privatizimin është i mirë, i qartë dhe konkret. Pra, i përmbush kushtet që të punohet sipas kësaj platforme që keni krijuar. Më vjen mirë se puna po bëhet me intensitet të shtuar. Me vemendje e kam precjellë edhe moratoriumin të cilin e keni parashtruar për Trepçën. Këto janë çështje me përgjegjësi për privatizimin. Lidhur me ligjin, i cili ka mangësi që i parashtruat, mendoj se ka mangësi dhe duhet ta bëjmë plotësimin e tij, që ato të eliminohen.

2. Sa i përket likuidimit ose bankrotimit e kemi nxjerr Ligjin për bankrotim. Mendoj se Ligji nuk është ideal, por i përmbush kërkesat për këtë fazë në të cilën është Kosova. Procesi i likuidimit në Kosovë dhe në vendet e rajonit, që e kanë pasur këtë proces, është shumë i ndërlikuar.

Për t'u sqaruar moratoriumi i Trepçës i parashtrroi disa pyetje: *Çfarë afati jepet për t'u përmbushur kërkesat që dalin nga memorandumit? Sa është në gjendje AKP-ja të kontribuojë në kthimin e pronave pronarve të tyre, në lirin e pronave të uzurpuara dhe*

t'ua kthejë pronarëve? Çka ka bërë Agjencia për disa ndërmarrje të privatizuara, që nuk i kanë përmbushur kontratat, si Llamkosi?

Kaqusha Jashari - Si kuptuam, ju ballafaqoheni me shume probleme, me Ligjin për Privatizim dhe me OVGJS-në. Po ashtu thatë se keni arritur ta formoni Komisionin për Kërkesa dhe Ankesa. Si komision duhet ta shqyrtojme mundesinë se çka mund t'ju ndimojmë lidhur me legjislacionin dhe ta inicojmë këtë çështje. Për Trepçën mendoj se duhet të konsiderohet dhe të trajtohet si pasuri shtetërore.

Pyetje: Meqë për kthimin e mjeteve të grumbulluara nga privatizimi (ngase në Raport nuk flitet), Bordi e ka marrë një vendim që ato të kthehen në Kosovë dhe t'u jepen bankave komerciale, çka po ndodh me to? 3. Cili ka qënë kriteri për privatizimin e disa ndërmarrjeve me Spinof special dhe me ato të rendomta?

Qamile Morina – 1. Ajo që më brengosi gjatë raportimit tuaj është se ju thatë ende në një mënyrë po funksionon AKM-ja. *Kjo çështje a duhet të trajtohet në nivel më të lartë, në atë qendror? Cilat janë ato dy vendime të ndjeshme për Kosovën, të cilat i ka marrë ish-AKM-ja? A mund të na i shpjegoni?* Ju thatë se menaxhmenti i ndërmarrjeve në Serbi ka filluar t'i privatizojë pronat e ndërmarrjeve në Kosovë. Thatë se i keni informuar presidentin, kryeministrin, Kuvendin dhe Zyrën Civile të EULEX-it. *Çka kanë ndërmarrë der tani? A ka përgjigje rreth kësaj çështjeje dhe a ka hapa konkretë të ndërpritet kjo?*

2 Për auditimin që i është bërë ish-AKM-së në vitin 2008, theksohen disa shkelje. *Çka keni bërë tani si AKP për t'i evituar këto shkelje dhe për ta rritur performacën e AKP-së?*

Fatmir Rexhepi –Vërejtjet të cilat i shtroi z. Bicaj lidhur me Ligjin, do të duhej ta shikonim mundesinë e ndryshimit dhe të plotësimit të tij. E shtroi nevojën e lidhjes së një marrëveshjeje ndërmjet Komunës dhe AKP-së për transformimin e pronës shoqërore - tokave bujqësore në pronë komunale për plotësimin e nevojave themelore infrastrukturale të komunës. Kjo çështje do të ishte me shumë interes, andaj do të ishte mirë që sa më parë të nxirret një ligj i veçantë, me të cilin do të rregullohet kjo kërkesë që është me shumë rëndësi për komunën. Sa i perket privatizimi dihet se e kemi zgjedhur këtë model dhe mundesitë për ta ndryshuar kanë qënë dhe janë te vogla, qoftë edhe për Spinofin special.

Sala Berisha – Shala - Raportin e vlerësoi teknikisht të hartuar mirë dhe shumë përmbajtjesor, sepse komunikimi, është i obligueshëm për çdo agjenci, që t'i raportojë Kuvendit për punën e vet. Raporti i përshkruan gjendjen dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohet AKP-ja. Ajo që u përmend nga perfaqësusi i AKP-së, ishte baza ligjore. Ne si deputetë dhe komision i kemi detyrat tona për nismën e ndryshimit të Ligjit. Prandaj, si deputetë, duhet t'i hyjmë kësaj nisme, sepse kemi mundësi vepruese për të gjitha ligjet që e rregullojnë sferën e ekonomisë, po ashtu dhe për Trepçën.

Shkumbin Bicaj - Theksoi se AKP-ja e ka për obligim t'i i informojë të gjitha institucionet, konkretisht ato përkatëse për punën e AKP-se. Raporti është pasqyra më e mirë si zhvillohet puna e Agjencisë dhe me çka po ballafaqohemi.

- Për Spinofin specila po e jap një sqarim se AKM-ja, e ka zbatuar legjislacionin e vet, të

mëparshëm. Ai legjislacion lejonte metodën e Spinofit special dhe atë të likuidimit.

- Metoda me Spinof special është përdorur për ndërmarrjet, që konsideroheshin me rëndësi strategjike të Kosovës. Kriter ishte që ndërmarrja me më se 300 punëtorë dhe me qarkullim vjetor me më se 10 milionë € Në atë kohë ishte një numër i vogël që e plotësonin këtë kriter. Kjo metodë ishte negative ngase punëtorët nuk informoheshin sa duhet dhe ishin premtuar vende pune. Në disa raste nuk janë realizuar, sepse nuk ishte e qartë, pasi nuk thuhej se do të mbetnin ata punëtorë, nuk u ishte garantur vendi i punës. Me këtë metodë më së shumti ka përfituar Feronikeli në Drenas, që i ka realizuar të gjitha obligimet. Deri diku dhe Fabrika e Birrës në Pejë.

- Për Llamkosin në Vushtrri që ka falimentuar, ish AKM- ja, ka marrë një vendim në bazë të Ligjit për tërheqjen e ish-aksioneve të pronarëve të mëparshëm. Ne e kemi trashëguar atë vendim. Ne borde është bërë një betejë për zbatimin e këtij vendimi. Jemi duke e percjellë vendimin në Bullgari, sepse kompania amë është atje. Ne kemi informata se kur e ka privatizur kjo kompani Llamkosin, ka qenë e falimentuar. Tani ne po ballafaqohem me një vendim të vështirë, por më në fund e kemi marrë në pronësi dhe kemi bërë pranimdorëzimin e objektit.

- Në aspektin juridik është shumë e vështirë të zbatohet, sepse kemi të bjeme me shumë kreditorë dhe me kompaninë. Kryesorja është që ne e kemi tani ndërmarrjen në dorë dhe po e shqyrtojmë mundësinë e tenderimit në mënyrën më të mirë.

- Për 20% , që u takon punëtorëve, në emër të kompensimit, kemi angazhur rreth 60 juristë – avokatë për shqyrtim dhe zgjidhje të ankesave, për të cilat kërkohet shumë kohë.

Për Raportin e auditorit kemi angazhuar auditorë të jashtëm, për arsye specifike, sepse duhet të jenë ekspertë të degëve të ndryshme.

- Për kontratat e shitblerjes veprohet në bazë të procedurave ligjore. Kompania që i ka përmbushur më se 80% të detyrimeve, fillon të lirohet nga kontrolli i AKP-së, sepse në bazë të politikave dhe të analizave del se është një investitor serioz. Ato ndërmarrje që nuk i përmbushin 40% të zotimeve me kontratë, mund t'i humbin aksionet.

- Për Brezovicën dy herë janë shpallur tenderë, në veçanti për disa objekte periferike. Më tepër e kemi pasur qëllim testimin e procesit të privatizimit në këto vendbanime që janë me shumë probleme të natyrës politike. AKP-ja tani i ka hapur 2 zyra në këto vendbanime me serbë.

- Për likuidimin mund t'ju informoj se për herë të parë është duke u berë një trajnim profesional i stafit për likuidim. Kemi 20 punëtorë që do të certifikohen në këtë lëmi. Procedura e falimentimit të ndërmarrjes shkon nëpërmjet gjykatës, e cila së pari e cakton një administrator. Në praktikë është një proces i vështirë për afarizëm të suksesshëm dhe nga aspekti ligjor gjendet zgjedhje e përkohshme.

- Për mjetet e privatizimit, është marrë vendim i Bordit që në atë kohë i është drejtuar Guvernatorit të Bankës Qendrore, me të cilin është kërkuar kthimi i mjeteve në Kosovë. AKP- ja në bazë të Ligjit ka vendosur dhe ka marrë vendim që këto mjete të depozitohen

në Bankën Qendrore të Kosovës. Për këtë kemi kërkuar sqarim nga Banka Qendrore, por nuk kemi marrë sqarim të saktë përse nuk po kthehen mjetet në Kosovë? Si AKP është primare që këto mjete të kenë siguri.

- Për pronat komunale, AKP-ja, së bashku me Ministrinë e Pushtetit Lokal, ka punuar një draft të Projektligjit për pronat komunale të paluajtshme dhe besojmë se shumë shpejt ky projektligj do procedohet në Kuvendin e Kosovës për miratim.

- Për Trepçën duhet të rregullohet statusi juridik, i veçantë dhe të jetë nën mbikëqyrjen e Qeverisë, sepse vazhdimisht ka marrë subvencione dhe po vazhdon të marrë edhe më tej nga Qeveria. Në aspektin juridik si AKP, kemi kompetenca të përziera në bazë të legjislacionit që operojmë me Oden e Veçantë të Gjykatës Supreme dhe AKM-së.

Në të ardhmen do të kemi një betejë juridike për Trepçën se kush do ta administrojë.

Pas diskutimit të gjerë Komisioni nxori përfundimin, me të cilin u miratua Raporti i Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) për periudhën gusht 2008 - gusht 2009.

Pas këtij vlerësimi Komisioni nxori rekomandimin me të cilin:

I rekomandohet Kuvendit të Republikës së Kosovës ta miratojë Raportin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit për periudhën gusht 2008 - gusht 2009.

Të ndryshme

Për mbledhjen e radhës (më 08. 12. 2009) do shqyrtohen dy p/ligje:

P/L për turizëm e shërbime turistike dhe Projektligji për shërbime postare.

Kryetare e Komisionit

Myzejene Selmani

